

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org Org.Jedimica Org.Unit	SP-02	Nr.Prot: Broj.Prot Prot.No	1050-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	03	Data: Datum: Date:	10.06.26 / 20
PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.06.2026
REFERENC-Ë:	26/1050/MMPH
PËR/ZA/TO:	"MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpcë Hydrocentrali "SHARRI" në Shtërpcë.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar dokumentacionin për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpcë, për Hydrocentrali "SHARRI" në Shtërpcë me nr. prot. 26/1050/MMPH.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

- Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për pajisje me Leje Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpcë, për Hydrocentrali "SHARRI" në Shtërpcë me nr. prot. 26/1050/MMPH.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/1050/MMPH

Datë: 10.06.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpçë, i ndërpritet procedura administrative me nr. prot. 26/1050/MMPH, datë: 06.03.2026, për pajisje me Leje Mjedisore për Hidrocentralin "SHARRI" në ngastrën kadastrale nr. 2374-0, zona kadastrale Shtërpçë.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës të operatorit "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpçë, për pajisje me Leje Mjedisore për Hidrocentralin "SHARRI" në ngastrën kadastrale nr. 2374-0, zona kadastrale Shtërpçë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 24.03.2026 si në vijim:

- Pëlqimin Mjedisor për ndërrim apo devijim të trasesë nga koordinatat e shënuara në raportin e VNM- së.

Operatori, në informatat shtesë të dorëzuara më datë 21.04.2026, nuk ka prezantuar Pëlqimin Mjedisor për ndërrim apo devijim të trasesë nga koordinatat e shënuara në raportin e VNM-së siç ka kërkuar komisioni paraprak.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: 10.06.2026, konstatoi se operatori "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., Shtërpcë, për Hydrocentralin "SHARRI", në ngastrën kadastrale nr. 2374-0, zona kadastrale Shtërpcë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të këtij vendimi.



U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Shtërpcës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.